



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

ANALIZA VJETORE 2015



Janar 2016

TABELA E LËNDËS

1. Treguesit sasiore të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2015.....	fq 1
2. Burimet e referimit të çështjeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015.....	fq 5
3. Treguesit e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2015.....	fq 8
3.1 Mosfillimet e procedimeve penale gjatë vitit 2015.....	fq 10
3.2 Çështjet penale të pushuara gjatë vitit 2015.....	fq 11
3.3 Çështje penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2015.....	fq 12
3.4 Çështjet penale të pezulluara gjatë vitit 2015.....	fq 13
3.5 Çështjet penale të transferuara gjatë vitit 2015.....	fq 14
4. Treguesit e të pandehurëve.....	fq 14
5. Treguesit e masave të sigurimit.....	fq 15
6. Treguesit e mënyrës së përfundimit të gjyqimit për çështjet penale të trajtuara gjatë vitit 2015.....	fq 16
7. Shpejtësia në hetime dhe zgjatja e afatit të hetimeve parapraçe gjatë vitit 2015.....	fq 17
8. Shfuqizimet e akteve të prokurorëve gjatë vitit 2015.....	fq 18
9. Përgjimet.....	fq 18
10. Apelimet e bëra nga Prokuroria gjatë vitit 2015.....	fq 18
11. Ngarkesa e punës së Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2015.....	fq 19
11.1 Treguesit e ngarkesës për Seksjonin e të Miturve gjatë vitit 2015.....	fq 22
11.2 Treguesit e ngarkesës për Njësinë e Përbashkët Hetimore Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit gjatë vitit	fq 23
Sekuestre.....	fq 29
Konfiskimet.....	fq 30
12. Ekzekutimet e vendimeve penale gjatë vitit 2015.....	fq 31
13. Kompesimi për burgim të padrejtë.....	fq 33
14. Aktiviteti i zyrës së financës për vitin 2015.....	fq 33
15. Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë gjatë vitit 2015.....	fq 34
16. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.....	fq 34
17. Problemet e konstatuara dhe prioritetet.....	fq 35

RELACION

Për analizën vjetore të treguesve të punës për vitin 2015

Ky raport pasqyron në mënyrë të përmbledhur rezultatet e veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, gjatë vitit 2015. Ai është përqëndruar në analizën e treguesve kryesore sasiorë të punës, treguesit cilësorë referuar edhe qëndrimeve të gjykatës, treguesit për secilin prokuror, problematikën gjatë ushtrimit të funksioneve të prokurorit në hetimet paraprake dhe në gjykim, me synimin për të evidentuar mangësitë dhe arritjet me qëllim përmirësimin e treguesve të punës për vitin që vijon.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për ushtrimin e veprimtarisë së saj, ka patur për vitin 2015 një organikë prej 43 punonjësish nga të cilët: 20 prokurorë, (ku përfshihen 1 drejtues dhe 2 zv/drejtues, 9 oficerë të policisë gjyqësore, 1 kancelar, 1 k/sekretare, 1 finaciere, 1 shofer, 1 ftues, 1 punonjës I.T., 7 sekretare/operatore dhe 1 punonjës pastrimi).

Gjatë vitit 2015, për arsye të ndryshme, kanë ushtruar veprimtarinë në këtë prokurori sipas periudhave kohore 20 deri 27 prokurorë, përfshi dhe drejtuesit.

Pranë kësaj prokurorie ka funksionuar seksioni i policisë gjyqësore i përbërë prej 14 oficerë të policisë gjyqësore, 9 juristë, 3 oficerë të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Vlorë, 1 oficer i policisë gjyqësore të D.P.Doganave dhe 1 oficer i policisë gjyqësore i D.R.Tatimore. Njëkohësisht kanë dhënë ndihmën dhe mbështetjen e tyre shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit të cilët kanë përballuar një peshë të konsiderueshme të hetimeve paraprake.

Sipas organizimit të brendshëm, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë kanë funksionuar rregullisht dy seksione, Njësia e Përbashkët Hetimore Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit, aktualisht me 4 prokurorë (1 zv/drejtues dhe 3 prokurorë) dhe Seksioni i të Miturve dhe Ekzekutimit të Vendimeve Penale, me 2 prokurorë.

1. Treguesit sasiorë të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2015.


Gjatë vitit 2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë regjistruar gjithsej 3553 kallëzime dhe referime për vepra të ndryshme penale. Prej tyre janë regjistruar gjithsej 2514 procedime penale dhe është vendosur mosfillimi për 1039 kallëzime penale. Gjatë vitit 2015 janë mbartur nga viti 2014 gjithsej 1022 procedime penale dhe së bashku me ato të regjistruara i takon të jenë trajtuar gjithsej

3536 procedime penale. Ndërkohë që për vitin 2015 rezulton të jenë mbartur 726 procedime penale si dhe 140 referime.

Krahasuar këta tregues me vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 sipas tabelës së mëposhtme rezulton:

<i>Totali i çështjeve të trajtuara</i>		<i>Të rregjistruara</i>	<i>Të mbartuara viti parardhës</i>	<i>Të tjera</i>	<i>Seksioni i të Miturve</i>	<i>Çështje të Njesisë (NJ.P.H.)</i>
<i>Viti 2015</i>	<i>4715</i>	<i>2514¹ + 1179² (1039³ mf)</i>	<i>1022</i>	<i>2988</i>	<i>205</i>	<i>500</i>
<i>Viti 2014</i>	<i>3983</i>	<i>2458 + 748 (608 mf)</i>	<i>777</i>	<i>1882</i>	<i>218</i>	<i>358</i>
<i>Viti 2013</i>	<i>3293</i>	<i>2138 + 688</i>	<i>467</i>	<i>1612</i>	<i>244</i>	<i>282</i>
<i>Viti 2012</i>	<i>2951</i>	<i>2025 + 541</i>	<i>385</i>	<i>1520</i>	<i>221</i>	<i>284</i>
<i>Viti 2011</i>	<i>2363</i>	<i>1616 + 416</i>	<i>329</i>	<i>1086</i>	<i>244</i>	<i>168</i>

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm, paraqiten si më poshtë:



Për vitin 2015, ka patur një volum më të madh pune krahasuar me vitet e mëparëshme, si duke ju referuar numrit më të lartë të njoftimeve për vepra penale, ashtu edhe në referencë të numrit të procedimeve penale të rregjistruara dhe trajtuara gjatë 2015. Rritja e numrit të njoftimeve për vepra penale nuk është shoqëruar me rritjen e numrit të procedimeve penale të rregjistruara, por evidentohet rritje e çështjeve të mosfilluara, çka përbën një tregues cilësor në momentin e vlerësimit të

¹ Procedime të rregjistruara për vitin 2015

² Referime që nuk kanë marrë numër procedimi penal


³ Çështje të mosfilluara për vitin 2015

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

materialit të referuar si dhe kushteve për regjistrimin e procedimit penal. Tregues i punës së kryer për vitin 2015 është numri i çështjeve të cilave u është dhënë zgjidhje ligjore, i cili është dukshëm më i lartë se treguesit e viteve të kaluara, çka reflektohet në numrin e procedimeve të mbartura për vitin në vijim. Kështu në raport me të dhënat e vitit 2014, evidentohet një rritje prej 29.5% e numrit të çështjeve të trajtuara gjatë vitit 2015, ndërkohë që çështjet e mbartura për vitin në vijim përbëjnë 15.3 % të totalit të çështjeve, kundrejt 25.6 % që përbënin për vitin 2014.

Viti	Totali i çështjeve të trajtuara	Çështje të përfunduara gjatë vitit	Çështje të mbartura për vitin pasardhës
2015	$2514^4 + 1022^5 + 1039^6 + 140^7 = 4715$	$2950 + 1039 = 3989$	726
2014	$2458 + 777 + 608 + 140 = 3983$	$2213 + 608 = 2821$	1022
2013	$2138 + 467 + 688 = 3293$	$1829 + 688 = 2517$	777
2012	$2025 + 385 + 541 = 2951$	$1943 + 541 = 2484$	467

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm paraqiten:



2. Burimet e referimit të çështjeve penale të regjistruara gjatë vitit 2015.

Përsa i përket burimeve të referimit të çështjeve penale të regjistruara dhe të trajtuara gjatë vitit 2015, është me vend të theksohet se në krahasim me vitin 2014, vihet re një rritje e materialeve të referuara nga shërbimet e policisë gjyqësore, nëpunësit publikë/institucionet si dhe rritje e ndjeshme e numrit të kallëzimeve nga

⁴ Procedime të regjistruara për vitin 2015

⁵ Procedime të mbartura prej vitit 2014

⁶ Mosfillime për vitin 2015

⁷ Çështje që nuk kanë marrë numër mosfillimi dhe procedimi gjatë vitit 2015

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

shtetasit. Më konkretisht treguesit e burimeve të referimit të çështjeve penale të rregjistruara gjatë vitit 2015 janë:

Burimi i referimit	2013	2014	2015
<i>Të rregjistruara kryesisht</i>	34	41	58
<i>Kallëzime nga nëpunësit publikë/institucionet</i>	75	64	88
<i>Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit</i>	3	2	2
<i>Nga ILDKP</i>		1	
<i>Nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave (FIU)</i>	7	11	4
<i>Nga Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH)</i>		2	4
<i>Nga Personeli mjekësor</i>		1	
<i>Nga Drejtoria e Tatim Taksave + Dogana</i>	-	1	30
<i>Kallëzime nga shtetas</i>	168	306	251
<i>Nga policia me vendngjarje</i>	835	980	1214
<i>Nga policia me kallëzim të shtetasve</i>	947	1691	1927
<i>Nga policia pyjore</i>	9	17	-
<i>Nga OSSHE</i>	6	92	95
<i>Nga I.N.U.V.-I.N.U.K,</i>	19	19	-
<i>Të tjera</i>			1068

Konstatohet një rritje e kallëzimeve të nëpunësve publikë dhe shtetasëve, konstatohet një numër pothuajse i njëjtë i kallëzimeve nga institucione të veçanta si O.SH.E.E., si dhe evidentohet një numër i konsiderueshëm kallëzimesh për vitin 2015 të referuara nga Drejtoria e Tatimeve si dhe nga D.P.Doganave, për fushat konkrete që ato mbulojnë.

Konstatohet se institucione të specializuara si ILDKP, FIU dhe SHISH, gjatë vitit 2015 kanë depozituar numër të pakët kallëzimesh penale.


Përsa i përket zërit, “çështjeve penale të rregjistruara kryesisht” këtu janë përfshirë edhe çështjet e rregjistruara mbi bazën e vendimeve të ndarjes së akteve nga çështje të tjera.

Në këndvështrim të figurave të veprave penale konkrete për të cilat janë rregjistruar procedimet penale,rezulton si më poshtë :

<i>Numri i procedimeve</i>	<i>Neni për të cilin janë trajtuar</i>
28	<i>Për nenin 84</i>
58	<i>Për nenin 89</i>
81	<i>Për nenin 130/a</i>
936	<i>Për nenin 134</i>
94	<i>Për nenin 137</i>
22	<i>Për nenin 139</i>
16	<i>Për nenin 141/a</i>
37	<i>Për nenin 143</i>

38	Për nenin 150
52	Për nenin 151
20	Për nenin 183
91	Për nenin 186
15	Për nenin 197
41	Për nenin 199/a
60	Për nenin 248
37	Për nenin 275
14	Për nenin 277
39	Për nenin 278
66	Për nenin 283
182	Për nenin 284
17	Për nenin 287
52	Për nenin 290
145	Për nenin 291
373	Për nene të tjera

Në mënyrë grafike kjo ndarje pasqyrohet si më poshtë:




Të para në këndëvështrim të grupimeve të veprave penale rezulton se janë rregjistruar, për vepra penale kundër personit 252 procedime penale me 154 të pandehur, prej të cilëve 39 me masë sigurimi “Arrest në burg”; për vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike janë rregjistruar 1598 procedime me 377 të pandehur, prej të cilëve 48 të arrestuar, për krime kundër mjedisit 8 çështje me 6 të pandehur, për vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues 1 çështje me 1 të pandehur; për vepra penale kundër autoritetit të shtetit 713 çështje me 382 të pandehur prej të cilëve 108 me masë sigurimi “arrest në burg”; për vepra penale kundër drejtësisë 41 çështje me 30 të pandehur.

3. Treguesit e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2015.


Gjatë vitit 2015, janë trajtuar një numër i konsiderueshëm procedimesh penale, gjithsej 3553. Prej tyre janë përfunduar gjithsej 2827 procedime, prej të cilave 32% janë dërguar për gjykim, 18.3 % janë pushuar, 47% janë pezulluar dhe 1,5% janë dërguar për kompetencë. Janë mbartur për vitin 2016 gjithsej 726 procedime penale. Më konkretisht treguesit e mënyrës së përfundimit të çështjeve penale të trajtuara gjatë vitit 2015 duke i krahasuar edhe me të dhënat e viteve 2012, 2013 e 2014 janë si më poshtë;

<i>Totali i çështjeve</i>		<i>Mosfillim</i>	<i>Pushim</i>	<i>Pezullim</i>	<i>Transferim</i>	<i>Gjykim</i>	<i>Të mbartura per vitin pasardhës</i>
<i>Viti 2015</i>	4575+140 ⁸	1039	518	1348	42	902	726 proc+140
<i>Viti 2014</i>	3843+140	608	429	1038	42	704	1022+140
<i>Viti 2013</i>	3294	688	324	883	26	596	777
<i>Viti 2012</i>	2951	541	463	744	27	709	467

Në mënyrë grafike treguesit e mësipërm paraqiten si më poshtë.



Shprehur në përqindje, mënyra e përfundimit të çështjeve në vitin 2015 paraqitet si më poshtë:



⁸ Një pjesë e materialeve të rregjistruara në fund të vitit janë në proces verifikimi (140)

Ajo që konstatohet nga të dhënat e mësipërme është fakti se numri i çështjeve penale të dërguara për gjykim dhe të pushuara, të pezulluara, të transferuara janë më lart se viti paraardhës, kjo për faktin se ka një shtim të konsiderueshëm të kallëzimeve penale të rregjistruara gjatë vitit. Tek çështjet e dërguara për gjykim vihet re një trend i njëjtë me vitet paraardhëse, gjykuar kjo nga numri i procedimeve të trajtuara.

Në rritjen e numrit të procedimeve penale të pezulluara, mendojmë se kanë ndikuar të metat e punës në veprimet e para hetimore, të cilat lidhen drejtpërdrejt me zbulueshmërinë. Gjithashtu rritja e numrit të procedimeve të pezulluara lidhet edhe me faktin se gjatë muajve Korrik e Gusht 2015 nga policia gjyqësore janë referuar një numër i konsiderueshëm procedimesh penale pa autorë për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike, të cilat janë pezulluar gjatë vitit 2015 dhe që ka ndikuar në këtë tregues.

Një përqindje të konsiderueshme në procedimet penale të pezulluara zënë edhe ato për veprën penale të vjedhjes, sidomos të vjedhjes së banesave. Ky fenomen është i përhapur në rrethin e Vlorës në stinët e pranverës, vjeshtës dhe dimrit ku një numër i konsiderueshëm apartamentesh e banesash janë të pa banuara dhe janë bërë objekt vjedhje të herëpashershme.

Çështjet penale për të cilat është shpallur moskompetenca, zënë në përqindje pothuajse të njëjtë vlerë me një vit më parë.

III/1. Mosfillimet e procedimeve penale gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 është vendosur mosfillimi i procedimit për 1039 kallëzime penale.

Është vendosur mosfillimi i procedimit penal në të shumtën e rasteve për veprat penale të “*Falsifikimit të dokumentave*” neni 186 i K.P dhe “*Shpërdorimit të detyrës*” neni 248 i K.P për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, për “*Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor*” neni 290 K.P dhe “*Dëmtimeve të tjera me dashje*” neni 90 K.P për shkak të pasojës dhe kategorisë së dëmtimeve mjeko-ligjore, për veprën penale të “*Shkatërrimit të pronës*” neni 150 K.P për shkak të vlerës së dëmit apo shkakut të dëmit, për veprën penale të “*Mashtrimit*” neni 143 K.P për shkak të ekzistencës së një marrëdhënie kontraktore civile, etj. Po kështu vihet re dyfishim i numrit të çështjeve të mosfilluara për veprat penale të parashikuara nga nenet 84,90,99 të K.P.

Më konkretisht, treguesit e dosjeve të mosfillimit të procedimeve penale në lidhje me veprat penale të trajtuara janë si më poshtë;

	<i>Viti 2014</i>	<i>Viti 2015</i>
<i>Neni për të cilin janë trajtuar</i>	<i>Numri i mosfillimeve</i>	<i>Numri i mosfillimeve</i>
<i>Per nenin 186</i>	44	62
<i>Per nenin 90</i>	29	88
<i>Per nenin 248</i>	74	68
<i>Per nenin 150</i>	46	60
<i>Per nenin 143</i>	35	57
<i>Per nenin 84</i>	42	87
<i>Për nenin 290</i>	33	40
<i>Për nenin 99</i>	36	70
<i>Për nenin 199/a</i>	37	51
<i>Për nenin 200</i>	21	32
<i>Të tjera</i>	211	424

Nga krahasimi i treguesve të punës gjatë vitit 2015 me ato të vitit 2014, rezulton se ka një rritje prej 41% të çështjeve të mosfilluara, ndërkohë që referimet e mbartur për vitin 2015 me statusin e vlerësimit, konstatohen në një numër të njëjtë me atë të vitit të kaluar.

Nga totali i vendimeve për mosfillimin e procedimit penal, janë kundërshtuar vendimet në gjykatë për 60 vendime mosfillimi. Referuar vendimarrjes së gjykatës për 50 raste nuk është pranuar ankimi i vendimit dhe për 10 raste gjykata ka pranuar ankimin duke urdhëruar fillimin e procedimit penal.

Ky tregues shpreh në mënyrë të qartë faktin se prokurorët i kanë kushtuar rëndësinë e duhur materialit referues dhe vendimarrja në lidhje me mosfillimin e procedimeve penale ka qënë e drejtë.

Në lidhje me fazën e verifikimit të materialeve referuese e kallëzuese, konstatohet fakti që ka raste që verifikimi zgjat tej afatit të përcaktuar në Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm. Në tejkalimin e këtij afati ndikojnë vonesat në përgjigjet për aktet e ekspertimit dhe vonesat në përgjigjet e informacioneve të kërkuara nga institucione të ndryshme. Për shkak të adresave të pasakta, ka patur probleme edhe në lidhje me njoftimin e vendimeve, të cilat në shumë raste nuk kanë arritur të komunikohen nga shërbimi postar.

III/2. Çështjet penale të pushuara gjatë vitit 2015.

Rezulton se gjatë vitit 2015 është vendosur pushimi për 518 çështje penale, të cilat në krahasim me numrin e çështjeve të pushuara në vitin 2014 përbëjnë 89 çështje më shumë. Pra rezulton një trend në rritje i çështjeve të pushuara në vlerën 17% që është në përpjestim të drejtë me rritjen e numrit të procedimeve. Veprat penale për të cilat është vendosur pushimi i procedimeve janë pak a shumë ato për të cilat është vendosur mosfillimi, ndërsa për shkaqet mund të themi se ato përfshijnë rastet e

parashikuara më së shumti prej gërmave “b”, “dh” dhe “d” të nenit 328/1 të K.Pr.Penale.

Më konkretisht, treguesit e çështjeve penale të pushuara, në mënyrë krahasimore me vitin 2015, janë si më poshtë :

	2013	2014	2015
Për nenin 186	33	25	56
Për nenin 89	30	54	32
Për nenin 248	24	32	31
Për nenin 199/a	19	13	27
Për nenin 275	26	39	30
Për nenin 150	12	21	20
Për nenin 84	12	11	17
Për nenin 76	12		1
Për nenin 78	12		
Për nenin 287	28	5	13
Të tjera	247	229	304

Nga totali i çështjeve të pushuara për vitin 2015, janë ankimuar në gjykatë 33 vendime. Gjykata ka lënë në fuqi 28 vendime dhe ka pranuar ankimin për 5 vendime pushimi për të cilat ka vendosur shfuqizimin dhe vazhdimin e hetimeve. Ballafaquar me qëndrimin e gjykatës rezulton se hetimet e çështjeve penale të kryera nga organi i prokurorisë në shumicën e rasteve kanë qenë të plota dhe vendimet e marra të bazuara në ligj dhe prova.

III/3. Çështje penale të dërguara për gjykim gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 janë dërguar për gjykim 902 procedime penale. Krahasuar me vitin 2014 ka një rritje prej 21% të procedimeve penale të dërguara për gjykim, kjo për faktin e rritjes së numrit të procedimeve të përfunduara për vitin 2015, por dhe punës më të mirë në fazën e hetimit paraprak. Tek çështjet e dërguara për gjykim numrin më të madh e zënë ato për veprën penale të “Vjedhja” neni 134 K.P., 95 procedime me 180 të pandehur, 61 me masë sigurimi “arrest në burg”, “Vjedhja e energjisë elektrike apo impulseve telefonike” neni 137 i K.P., 110 procedime me 110 të pandehur, 15 me masë sigurimi “arrest në burg”; “Prodhimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike” neni 283 i K.P., 36 procedime me 51 të pandehur, 30 me masë sigurimi “arrest në burg”, “Dhuna në familje” neni 130/a i K.P., 63 procedime me 67 të pandehur, 14 “arrest në burg”, “Vjedhja me dhunë” neni 139 K.P. dhe “Vjedhja me armë” neni 140 K.P., 9 procedime me 13 të pandehur, 11 “arrest në burg”, “Vrasje me dashje”, “Vrasje në rrethana cilësuese”, “Vrasje me paramendim”, nenet 76, 78 e 79 procedime, me 7 të pandehur, 7 “arrest në burg”,

“Ndërtimi i paligjshëm” neni 199/a K.P., 49 procedime me 49 të pandehur, “Falsifikim i dokumentave” neni 186 K.P. 21 procedime me 31 të pandehur, “Shpërdorim i detyrës” neni 248 i K.P., 15 procedime me 21 të pandehur, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” neni 278 K.P., 24 procedime me 25 të pandehur, 24 “arrest në burg”, etj.

Treguesit e çështjeve penale të dërguara për gjykim janë si më poshtë

	<i>Numri i çështjeve të dërguara për gjykim 2014</i>	<i>Numri i çështjeve të dërguara për gjykim 2015</i>
<i>Për nenin 134</i>	<i>144 – 176 të pandehur – 77 a.burg</i>	<i>95-180 të pandehur -61 a.burg</i>
<i>Për nenin 89</i>	<i>26 – 27 të pandehur</i>	<i>34-50 të pandehur</i>
<i>Për nenin 199/a</i>	<i>23 – 23 të pandehur – 1 a.burg</i>	<i>49-49 të pandehur</i>
<i>Për nenin 186</i>	<i>16 – 19 të pandehur</i>	<i>21-31 të pandehur</i>
<i>Për nenin 248</i>	<i>11 – 18 të pandehur</i>	<i>15-21 të pandehur</i>
<i>Për nenin 259</i>	<i>2 - 3 të pandehur – 1 a.burg</i>	<i>2-5 të pandehur -2 a.burg</i>
<i>Për nenin 130/a</i>	<i>28 – 31 të pandehur – 7 a.burg</i>	<i>63-67 të pandehur-14 a. Burg</i>
<i>Për nenin 197</i>	<i>30 – 30 të pandehur</i>	<i>13-13 të pandehur</i>
<i>Për nenin 290</i>	<i>19 - 19 të pandehur – 6 a.burg</i>	<i>20-20 të pandehur-3 a.burg</i>
<i>Për nenin 283</i>	<i>16 – 18 të pandehur – 8 a.burg</i>	<i>36-51 të pandehur-30 a.burg</i>
<i>Për nenin 284</i>	<i>6 - 6 të pandehur – 3 a.burg</i>	<i>19-19 të pandehur-12 a.burg</i>
<i>Për nenin 287</i>	<i>1 – 2 të pandehur</i>	<i>3- 4 të pandehur</i>
<i>Për nenin 278</i>	<i>25 – 25 të pandehur – 20 a.burg</i>	<i>24-25 të pandehur -24 a.burg</i>
<i>Për nenin 275</i>	<i>1 - 1 të pandehur</i>	<i>5-5 të pandehur</i>
<i>Për nenin 79</i>	<i>3 - 4 të pandehur – 4 a.burg</i>	<i>5-6 të pandehur- 6 a.burg</i>
<i>Për nenin 78</i>	<i>1 - 2 të pandehur – 2 a.burg</i>	<i>1-1 të pandehur -1a.burg</i>
<i>Për nenin 76</i>	<i>3 – 3 të pandehur – 3 a.burg</i>	
<i>Për nenin 139-140 141</i>	<i>10 – 21 të pandehur – 17 a.burg</i>	<i>9- 13 të pandehur -11 a.burg</i>
<i>Për nenin 181</i>	<i>5 - 5 të pandehur</i>	<i>3-3 të pandehur</i>
<i>Për nenet 172/174</i>	<i>5 - 5 të pandehur</i>	<i>2-5 të pandehur</i>
<i>Për nenin 137</i>	<i>48 - 48 të pandehur- 10 a.burg</i>	<i>110-110 të pandehur -15 a. burg</i>
<i>Për nenin 135</i>	<i>3 - 3 të pandehur - 1 a.burg</i>	<i>6-6 të pandehur -5 a.burg</i>
<i>Të tjera</i>	<i>369</i>	<i>364</i>

Duke qënë se disa prej veprave penale të mësipërme, kanë qënë fenomen shqetësues në rreth, janë bërë të gjitha përpjekjet në bashkëpunim edhe me policinë gjyqësore, për t'i kushtuar rëndësinë e duhur çështjeve penale që kanë lidhje me veprat e mësipërme, me qëllim që hetimet paraprake në lidhje me këto vepra të jenë sa më të plota, të kryhen në afate optimale dhe të rritet zbulueshmëria për të vënë para përgjegjësisë penale autorët të cilët janë burim rreziku për shoqërinë.

III/4. Çështjet penale të pezulluara gjatë vitit 2015

Rezulton se gjatë vitit 2015 janë pezulluar për moszbulim të autorëve të veprës penale 1348 çështje penale, që në krahasim me numrin e çështjeve të pezulluara në vitin 2014 rezulton 22.9% më shumë si dhe përbën 47% të çështjeve të përfunduara gjatë vitit 2015.

Më konkretisht, treguesit e çështjeve penale të pezulluara në lidhje me veprat penale të trajtuara në to paraqiten si më poshtë;

<i>Vepra penale</i>	<i>Viti 2014</i>	<i>Viti 2015</i>
<i>Për nenin 134 të K.P.</i>	<i>734</i>	<i>905</i>
<i>Për nenin 150</i>	<i>36</i>	<i>25</i>
<i>Për nenin 151</i>	<i>25</i>	<i>44</i>
<i>Për nenin 284</i>	<i>120</i>	<i>151</i>
<i>Për nenin 283</i>	<i>8</i>	<i>12</i>
<i>Për nenin 78</i>	<i>3</i>	<i>3</i>
<i>Të tjera</i>	<i>112</i>	<i>208</i>

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se numri i çështjeve penale të regjistruara dhe të pezulluara për nenin 134 të Kodit Penal është i konsiderueshëm dhe rritja e kësaj figure bazohet në faktorë socialë dhe ekonomikë.

Një përqindje të konsiderueshme zënë edhe çështjet penale të pezulluara për veprat penale që lidhen me shkatërrimin e pronës, kultivimin e bimëve narkotike dhe mbajtjen së lëndëve narkotike.

Treguesit në rritje të procedimeve penale të pezulluara, janë të lidhura ngushtësisht me cilësinë e materialeve referues dhe posaçërisht me veprimet e para hetimore. Për të përmirësuar këta tregues duhet një kujdes i veçantë nga policia gjyqësore në këqyrjet e vendit të ngjarjes. Duhet gjetur rrugë e mënyra të ndryshme, për të afruar informacionin e nevojshëm për autorët dhe gjetjen e mjeteve e metodave ligjore për të kthyer në prova të gjitha të dhënat që administron policia gjyqësore për rastin.

Në shumë raste, veprimet e para hetimore, si kqyrja e vendit të ngjarjes, zbulimi, fiksimi dhe marrja e gjurmëve dhe provave materiale që kanë lidhje me zbulimin e mekanizmit dhe autorëve, kanë qenë jo të plotë dhe të kryera në mënyrë jo profesionale. Kryerja e ketyre veprimeve me përpikmëri dhe përgjegjësi do të çonte në hetimin e plotë të ngjarjes dhe zbulimin dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të kryerjes së veprës.

III/5. Çështjet penale të transferuara gjatë vitit 2015.

Rezulton se gjatë vitit 2015 është shpallur moskompetenca për 42 procedime penale.

Vendimet në lidhje me shpalljen e moskompetences dhe kalimin e akteve kanë qënë objekt i konfliktit për kompetencë, tek Prokurori i Përgjithshëm, në 1 rast ku vendimet e marra prej prokurorëve të Prokurorisë së Vlorës është gjetur i pabazuar dhe dosjet janë rikthyer për kompetencë në këtë prokurori.

4. Treguesit e të pandehurëve

Gjatë vitit 2015, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, janë marrë 1213 shtetas në cilësinë e të pandehurit dhe 410 shtetas në cilësinë e personit nën hetim, nga të cilët 1076 shtetas janë dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Më konkretisht, treguesit e të pandehurve për vitet 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

<i>Viti</i>	<i>Totali</i>	<i>Të pandehur</i>	<i>P.në hetim</i>	<i>Pushuar</i>	<i>Transferuar</i>	<i>Pezulluar</i>	<i>Gjykim</i>
2015		1213-335 a.burg	410	3+118 p.hetim	6+18 p.hetim		1076-268 a.burg
2014		1064-362-arrest	377	6+97 p.hetim	12+17 p.hetim	3 p.hetim	805-226 a.burg
2013		988- 320 arrest	356	7 + 105 p.hetim	9 + 3 p.hetim	-	753- 240 a.burg

5. Treguesit e masave të sigurimit.

Gjatë vitit 2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë janë referuar në funksion të procedimeve penale të rregjistruara 546 raste të personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar.

Për personat e arrestuar dhe ndaluar, nga ana e prokurorëve është urdhëruar lirim i menjëhershëm në 8 raste, dhe në 538 raste janë dërguar aktet në gjykatë për vleftësim arresti në flagrancë/ndalimi dhe është kërkuar në 425 raste caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” dhe kërkesë e pranuar nga gjykata në 353 raste. Për rastet e tjera gjykata ka caktuar si masë sigurimi “Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, “Arrest në shtëpi”.

Treguesit e masave të sigurimit, referuar edhe qëndrimeve që ka mbajtur gjykata, flasin për një politikë të drejtë të ndjekur nga prokuroria në lidhje me

caktimin e masave të sigurimit. Kujdes i veçantë është treguar në rastet kur personat e dyshuar kanë qënë të mitur, pasi në lidhje me ta veç moshës janë mbajtur parasysh edhe rrethana të tjera shoqërore e sociale për të qënë sa më objektiv e të kujdesshëm në caktimin e masës së sigurimit.

Treguesit e masave të sigurimit janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

<i>Totali i arrestimeve/ndalimeve</i>	<i>Lirim i menjëhershëm Neni 257</i>	<i>Kërkesa e prokurorisë Neni 258</i>	<i>Vendimi i gjykatës Neni 259</i>
546	8	538	538
<i>Vleftësime të ligjshme</i>		538	536
<i>Vleftësime të paligjshme</i>			2
<i>Arrest në burg</i>		425	353
<i>Arrest me afat</i>		18	18
<i>Arrest në shtëpi</i>			4
<i>Detyrim paraqitje</i>		72	140
<i>Garanci pasurore</i>		1	1
<i>Arrest në mungesë</i>		22	22


6. Treguesit e mënyrës së përfundimit të gjykimit për çështjet penale të trajtuara gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2014, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë përfunduar gjykimet e 719 çështjeve penale me 880 të pandehur.

Më konkretisht treguesit e gjykimit të çështjeve penale janë si më poshtë;

<i>Totali i çështjeve të gjykuara</i>	<i>Gjykim i drejtëpërdrejtë</i>	<i>Gjykim i shkurtuar</i>	<i>Gjykim i zakonshëm</i>	<i>Gjykim në mungesë</i>
719 - 880 të pandehur	67 –71	607 – 750	34 – 45	11 - 14

Treguesit e mësipërm paraqiten në grafikën që vijon:



Nga totali i çështjeve të gjykuara, nga ana e organit të prokurorisë gjatë vitit 2015, është kërkuar dënimi i të pandehurve me gjobë në 141 raste, tërheqje aktesh në 2 raste, pushim çështje në 27 raste, në rastet e tjera është kërkuar dënim me burgim, në 3 raste burgim i përjetshëm, në 2 raste ulje dënimi nën minimum. Janë gjithsej 81 raste me kërkesë për dënim me kusht, të cilat i referohen më së shumti rasteve me të pandehur të mitur, për arsye të politikës së ndjekur për këtë kategori personash.

Të dhënat paraqiten në tabelën si më poshtë:

<i>Llojet e dënimeve</i>	<i>Kërkesa e prokurorisë</i>	<i>Vendimi i gjykatës</i>
<i>Dënim me gjobë</i>	141	136
<i>Dënim me burgim (mesatar)</i>	611	486
<i>Dënim me burgim (maksimal)</i>	12	12
<i>Paraburgim</i>	1	
<i>Ulje dënimi nën minimum</i>	2	2
<i>Pezullim ekzekutimi dënimi</i>	81	164
<i>Burgim të përjetshëm</i>	3	2
<i>Tërheqje aktesh</i>	2	2
<i>Pushim çështje</i>	27	33
<i>Pafajësi</i>		42

Gjatë vitit 2015 pafajësitë janë marrë për veprat penale të mëposhtme:

- | | |
|-------------------|------------|
| - Për nenin 130/a | 1 pandehur |
| - Për nenin 134 | 5 pandehur |
| - Për nenin 137 | 3 pandehur |
| - Për nenin 139 | 1 pandehur |
| - Për nenin 143 | 3 pandehur |
| - Për nenin 156 | 1 pandehur |
| - Për nenin 161 | 2 pandehur |
| - Për nenin 172 | 4 pandehur |
| - Për nenin 181 | 1 pandehur |
| - Për nenin 186 | 3 pandehur |
| - Për nenin 244 | 1 pandehur |

- Për nenin 248	11 pandehur
- Për nenin 259	1 pandehur
- Për nenin 283	1 pandehur
- Për nenin 300	3 pandehur
- Për nenin 306	1 pandehur

Për shumë nga rastet e pafajësisë ne vazhdojmë të mbetemi konseguentë në qëndrimet tona para gjykatës dhe sot është rasti të analizojmë e vlerësojmë këto qëndrime me qëllim unifikimin e një qëndrimi për raste të tjera të ngjashme.

Për të gjitha rastet është mbajtur qëndrimi ligjor duke ankimuar vendimet e gjykatës.

7. Shpejtësia në hetime dhe zgjatja e afatit të hetimeve paraprake gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 rezulton se për çështjet që janë trajtuar nga organi i prokurorisë janë marrë zgjatje e afatit të hetimeve paraprake për 132 çështje me 166 persona në hetim apo të pandehur nga të cilët, 56 kanë qenë me masë sigurimi “arrest në burg”. Nga këto zgjatje afati, 71 janë bërë vetëm me 3 (tre) muaj, 37 janë bërë nga 3-6 muaj, 21 raste nga 6-9 muaj, dhe 3 raste deri në 1(një) vit.

Rrethanat që kanë çuar në zgjatje të afatit të hetimeve lidhen kryesisht me disponibilitetin për shkak të ndryshimeve strukturore të policisë gjyqësore, vonesat në administrimin e akteve dhe informacioneve të tjera nga institucionet, vështirësi në saktësimin e adresave dhe gjetjen e personave që pyeten, mungesë angazhimi dhe përkushtimi sa duhet të strukturës së policisë gjyqësore.

Si shkak specifik për vitin 2015, përse i përket zgjatjes së afatit të hetimeve, renditet edhe vonesat në kryerjen e ekspertimeve kryesisht ato biokimike pranë D.P.SH.Tiranë.

8. Shfuqizimet e akteve të prokurorëve gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 rezultojnë të jenë shfuqizuar nga prokurori më i lartë 28 çështje penale, nga të cilat 22 janë shfuqizuar nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe 6 nga Prokurori i Përgjithshëm.

9. Përgjimet

Rezulton që gjatë viti 2015 në funksion të procedimeve penale të jenë nxjerrë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë 134 vendime për lejim përgjimi, zgjatje afati përgjimi. Njëkohësisht rezulton se prej prokurorëve janë nxjerrë 32 vendime për lejime përgjimi në ambiente publike.

10. Apelimet e bëra nga Prokuroria gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ka paraqitur në gjykatë në total 204 ankime për vendime themeli të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe 54 apele kundërshtuese.

Gjatë vitit 2015 janë paraqitur 67 ankime kundër vendimeve për caktimin e masës së sigurimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nuk mund të japim të dhëna statistikore për qëndrimet që ka mbajtur gjykata e Apelit Vlorë në lidhje me apelet dhe apelet kundërshtuese të bëra gjatë vitit 2015.

Për ushtrimin e të drejtës së ankimit është mbajtur parasysh Urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm. Kështu pjesa më e madhe e ankimeve janë për vendimet e pafajësisë së plotë apo të pjesshme të dhënë nga gjykata si dhe për rastet e ndryshimit të cilësimit të veprës penale. Gjithashtu është ushtruar e drejta e ankimit edhe në rastet kur ka patur diferenca midis sanksioneve të kërkuara nga prokurori me ato të vendosura nga gjykata.

Ka patur një bashkërendim të mirë të punës me Prokurorinë e Apelit Vlorë në lidhje me problematikat e hasura gjatë gjyqimit të çështjeve duke unifikuar qëndrimet dhe rakorduar praktikat për rastet e ngjashme.

11. Ngarkesa e punës së Prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015, nga prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë është përballuar një ngarkesë e konsiderueshme pune si në fazën e hetimeve paraprake dhe në gjykim.

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të dhënat e ngarkesës së prokurorëve në fazën e hetimeve paraprake dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve prej tyre.

<i>Nr.</i>	<i>Prokurori</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Mosfill.</i>	<i>Pezulluar</i>	<i>Pushuar</i>	<i>Gyqit</i>	<i>Transf.</i>	<i>Bashk.</i>	<i>Në Hetim</i>
1	<i>R.Troci</i>	5	1	0	5	0	0	0	0
2	<i>A.Ismailukaj</i>	47	21	8	2	2	1	0	34
3	<i>A.Kulici</i>	182	51	18	43	39	4	12	66
4	<i>A.Saliu</i>	73	13	25	8	25	1	4	10
5	<i>A.Xhaferraj</i>	106	38	45	4	23	0	4	30
6	<i>A.Zarka</i>	244	81	109	25	78	1	7	24
7	<i>D.Marku</i>	270	76	114	40	68	4	8	36
8	<i>E.Alvora</i>	262	59	130	48	61	1	7	15
9	<i>E.Cela</i>	240	89	89	42	60	0	4	45
10	<i>E.Laze</i>	240	72	116	28	69	4	1	22
11	<i>E.Mustafaj</i>	37	11	0	0	1	2	0	34
12	<i>F.Cela</i>	270	68	124	46	71	3	4	22
13	<i>H.Lamaj</i>	217	50	55	26	93	8	5	30
14	<i>K.Braho</i>	101	21	12	30	22	6	1	30
15	<i>K.Llaho</i>	136	63	37	11	21	2	6	59
16	<i>M.Sota</i>	54	15	27	4	3	0	0	20
17	<i>V.Mata</i>	51	30	18	0	7	0	2	24
18	<i>S.Dautaj</i>	59	19	20	5	25	1	2	6
19	<i>S.Smaka</i>	293	64	127	47	79	2	7	31
20	<i>S.Lule</i>	44	10	11	3	3	0	2	25
21	<i>Xh.Salijaj</i>	290	48	129	41	82	1	7	30
22	<i>E.Ademi</i>	34	11	25	7	2	0	0	0
23	<i>A.Mocka</i>	136	64	67	23	42	1	3	0
24	<i>E.Hyka</i>	82	44	12	12	11	0	47	0
25	<i>D.Tafilj</i>	44	20	21	12	11	0	0	0
26	<i>M.Shehu</i>	15	0	8	6	1	0	0	0
27	<i>V.Starova</i>	4	0	1	0	3	0	0	0
	SHUMA	3536	1039	1348	518	902	42	133	593

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se shumë prej prokurorëve kanë trajtuar gjatë fazës së hetimeve paraprake mbi 250 procedime penale. Një numër prej 11 (njëmbëdhjetë) prokurorësh e konkretisht D.Tafilj, E.Ademi, A.Mocka, M.Sota, S.Lule, M.Shehu, A.Ismajlukaj, E.Mustafaj, V.Mataj, E.Hyka, A.Xhaferraj për shkaqe të ndryshme nuk kanë ushtruar funksionin gjatë gjithë vitit 2014. Për prokurorin S.Dautaj duhet të kemi parasysh se veç hetimit ka qënë i ngarkuar edhe me ekzekutimin e vendimeve penale, prokurori M.Shehu (veç hetimit ka ndjekur në gjykatë edhe gjykimet në çështjet penale më të dëmtuar akuzues dhe në çështjet civile.

Për vitin 2015 janë përfunduar në gjykim 719 çështje penale dhe 25 çështje që janë ndjekur drejtpërdrejt në gjykatë. Të ndara sipas prokurorëve, statistikave e çështjeve të gjykuara janë të pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

Analiza Vjetore 2015

<i>Nr.</i>	<i>Prokurori</i>	<i>Çështjet në gjykim</i>
1	<i>E. Cella</i>	43
2	<i>A. Saliu</i>	17
3	<i>Xh. Saliu</i>	71
4	<i>S. Dautaj</i>	26
5	<i>V. Starova</i>	3
6	<i>M. Sota</i>	5
7	<i>D. Tafili</i>	9
8	<i>A. Zarku</i>	65
9	<i>E. Alvara</i>	54
10	<i>E. Ademi</i>	12
11	<i>E. Laze</i>	44
12	<i>M. Shehu</i>	2
13	<i>A. Kulici</i>	29
14	<i>F. Cella</i>	67
15	<i>K. Llahe</i>	22
16	<i>D. Marku</i>	60
17	<i>S. Smaçi</i>	39
18	<i>H. Lamaj</i>	92
19	<i>S. Lule</i>	1
20	<i>K. Braho</i>	22
21	<i>E. Hyçi</i>	10
22	<i>A. Moçi</i>	18
23	<i>A. Xhaferraj</i>	7
24	<i>V. Mata</i>	1
TOTALI		719

Më i ngarkuar në gjykim ka qënë prokurori H.Lamaj i cili mbulon seksionin e të miturve në këtë prokurori, ngarkesë që vjen për faktin se procedimet penale në këtë seksion janë me autorë të identifikuar dhe pjesa më e madhe e tyre dërgohen për gjykim. Ngarkesa për prokurorët e tjerë ka qënë më e lartë në krahasim me një vit më parë, diferencat e theksuara i referohen prokurorëve që nuk kanë ushtruar funksionin gjatë gjithë vitit kalendarik.

Gjatë vitit 2015 nga oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është përballuar një ngarkesë sipas të dhënave të pasqyruara më poshtë;

<i>Nr.</i>	<i>Of.Pol. Gjyqësore</i>	<i>Totali i çështjeve</i>	<i>Të përfunduara</i>	<i>Të mbartura</i>
1	<i>Granit Cakërrri</i>	61	57	4
2	<i>Arben Jorgaqi</i>	151	138	13
3	<i>Altin Mucaj</i>	84	55	29
4	<i>Oltion Bëshitiq</i>	196	182	14
5	<i>Skërdilajd Qinami</i>	154	128	26
6	<i>Roland Kamberi</i>	153	134	19
7	<i>Mirjan Fani</i>	57	28	29
8	<i>Fatbardhë Lala</i>	74	49	25
9	<i>Arjela Rexha</i>	26 +ekzekutimet	24	2

Ashtu sic edhe rezulton nga të dhënat e mësipërme, oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, gjatë vitit 2015 kanë patur një ngarkesë të konsiderueshme pune në fazën e hetimit paraprak.

Oficere e Pol.Gjyqësore Arjela Rexha ka mbuluar gjatë vitit 2015 seksionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

X/1. Treguesit e ngarkesës për Seksionin e të Miturve gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 Seksioni i të Miturve ka patur në përbërje të tij dy prokurorë dhe konkretisht prokurorët Dritan Markuv(që ka zëvendësuar prej muajit Shtator 2015 prokurorin Hyrjet Lamaj) dhe Skënder Dautaj si dhe oficerin e policisë gjyqësore Skërdilajd Qinami.

Seksioni i të Miturve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, siç dihet mbulon çështjet me të mitur edhe për rrethet e Skraparit, Beratit, Lushnjës dhe Fierit. Ky seksion gjatë vitit 2015 ka hetuar dhe gjykuar një numër të konsiderueshëm çështjesh penale dhe krahasuar me statistikën e viteve 2012,2013, ngarkesa për vitin 2014 ka qënë pothuajse e njëjtë.

Në çështjet që ka trajtuar seksioni i të miturve kujdes i veçantë i është kushtuar caktimit të masave të sigurimit. Gjithashtu edhe në kërkesat për masë dënimi është mbajtur parasysh fakti se subjektet janë persona të mitur dhe lloji dhe masa e dënimit të dhënë ka qënë gjithnjë e kushtëzuar nga ky fakt dhe sigurisht ka patur për bazë parashikimet ligjore për veprën e kryer. Qëndrim i ashpër është mbajtur për të miturit që kanë rezultuar përsëritës dhe për rastet kur vepra është kryer në rrethana të cilësuar.

Më konkretisht treguesit e ngarkesës së punës së Seksionit të të Miturve janë si më poshtë:

<i>Viti</i>	<i>Totali çështje</i>	<i>Çështje të Vlorës</i>	<i>Çështje të rretheve</i>	<i>Mosfillim</i>	<i>Pushim</i>	<i>Pezullim</i>	<i>Transf.</i>	<i>Gjykim</i>	<i>Të mbartura</i>
2012	221	83	138	10	17	14	4	146	30
2013	244	87	157	26	23	14	6	134	67
2014	218	49	168	23	16	16	10	124	29
2015	205	36	139	18	9	10	6	136	25

Ajo që vihet re në trajtimin e çështjeve penale me të mitur është fakti se pjesa më e madhe e çështjeve të rregjistruara kanë qenë kryesisht për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal si dhe “Drejtimit mjeteve në mënyrë të pa rregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Ndërkohë që në ndryshim nga vitet e kaluara në vitin 2015 janë rregjistruar dhe procedime penale për veprat penale në fushën e krimeve seksuale me të mitura, por dhe në atë të kultivimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike.

X/2. Treguesit e ngarkesës për Njësinë e Përbashkët Hetimore Kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015 në përbërje të Njesisë së Përbashkët Hetimore, kanë punuar tre prokurorë, Drejtuesi i Njesisë, si dhe tre oficerë të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë, një oficer i policisë gjyqësore i Drejtorisë së Tatimeve dhe një oficer i policisë gjyqësore i Drejtorisë së Doganave.

Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2015 në Njësi kanë punuar Drejtuesi i Njesisë dhe Prokurorët Albert Kulici e Ervisa Hyka, ndërsa në muajin Mars të vitit 2015 është shtuar si pjesë përbërëse e Njesisë edhe Prokurorin Kledian Llaho. Në muajin Tetor 2015 Prokurorin Ervisa Hyka është transferuar në një Prokurori tjetër, ndërsa në muajin Nëntor është ngarkuar me hetimin e procedimeve penale të Njesisë edhe Prokurorin Elion Mustafaj, kryesisht më procedimet penale të filluara mbi bazën e kallëzimeve penale të A.K.K.P-së Tiranë.

Pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, veprat penale të Njesisë janë hetuar nga oficerët e policisë gjyqësore pranë Sektorit Kundër Krimit Financiar.

Për vitin 2015 nga ana e Njesisë së Përbashkët Hetimore ka pasur një ngarkesë pune të konsiderueshme, si dhe një dinamikë të lartë të veprave penale në hetim dhe në fazën e gjykimit.

Për shkakun se në Qarkun Vlorë ka ekzistuar dhe ekziston një problematikë specifike lidhur me njohjen dhe kthimin e pronave, rregjistrimin e tyre, ndarjen e

tokës bujqësore, problematikë që është e trashëguar nga veprimtaria e institucioneve të administratës publike në vite, edhe për këtë vit pjesa më e madhe e referimeve penale dhe kallëzimeve penale lidhen me mosmarrëveshjet e pronësisë, si dhe me veprime apo mosveprime të funksionarëve publike të lidhura me çështjet e pronësisë.

Gjatë vitit 2015 nga NJPH-ja janë trajtuar në total 472 referime penale dhe kallëzime penale, prej të cilave janë regjistruar 301 procedime penale të reja, si dhe është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 159 referime penale dhe kallëzime penale.

Për vitin 2015 numëri i kallëzimeve dhe referimeve penale është rritur në masën 41 % krahasuar me vitin 2014, që përkon me 138 kallëzime dhe referime penale më tepër, ndërsa numëri i procedimeve penale të reja është rritur në masën 68 % krahasuar me vitin 2014, që iu korespondon 122 procedime penale më tepër.

Rezulton se gjatë vitit 2015 janë hetuar gjithsej 429 procedime penale, janë përfunduar hetimet për 236 procedime penale, 76 janë dërguar për gjykim, është vendosur pushimi për 104 procedime penale, 37 janë pezulluar, ndërsa 17 janë transferuar ose bashkuar.

Duke iu referuar këtyre të dhëna rezulton se në vitin 2015, janë hetuar 52 % më tepër procedime penale se më vitin 2014, që iu korespondon numëri prej 149 procedime penale më tepër, janë përfunduar hetimet për 45 % më tepër procedime penale krahasuar me vitin 2014, që iu korespondon numëri prej 75 procedime penale më tepër, si dhe janë dërguar në gjyq 42 % më tepër procedime penale më tepër krahasuar me vitin 2014, që iu korespondon numëri prej 24 procedime penale më tepër sesa në vitin 2014.

Më konkretisht, po i paraqesim të dhënat për secilin nga Prokurorët në tabelën si më poshtë vijon;

Prokurorët	Totali	Referime	Kryesisht	Mosfilluar	Ne vritikim	Mbartur nga viti 2014.	Procedime të reja	Totali i procedimeve ne hetim	Pushime	Pezullime	Transferim	Gjykim	Totali përfunduar hetimet	Mbartur ne hetim per vitin 2016	Mbartur ne gjykim nga 2014	Gjithsej ne gjykim	Përfunduar gjykimi gjithsej procedime	Fajesi	Pafajesi ose pushim	Mbartur ne gjykim per vitin 2016
K.B	79	67	12	19	1	41	59	100	35	13	5	19	72	28	18	35	21	17	4	14
A.K	156	146	10	47	-	58	109	167	45	13	12	26	96	71	10	36	20	16	4	16
K.Ll	127	125	2	44	16	7	67	74	5	2	-	11	18	56	1	25	4	2	2	21
E.M	70	69	1	7	23	2	40	42	1	-	2	1	4	38	-	1	-	-	-	1
E.H	68	65	3	42	-	20	26	46	18	9	-	19	46	-	7	8	8	5	3	-
Tot.	500	472	28	159	40	128	301	429	104	37	19	76	236	193	36	105	53	40	13	52

Treguesit për vitin 2014 kanë qënë si më poshtë;

Prokuroret	Totali	Referime	Kryesisht	Mosfilluar	Ne verifikim	Mbartur nga viti 2013.	Procedime te reja	Totali i procedime ne hetim	Pushime	Pezullime	Transferim	Gjykim	Totali perfunduar hetimet	Mbartur ne hetim per vitin 2015	Mbartur ne gjykim nga 2013	Gjithsej ne gjykim	Perfunduar gjykimi gjithsej procedime	Fajesi	Palajesie ose pushim	Mbartur ne gjykim per vitin 2015
K.B	97	82	15	28	5	53	64	117	41	13	4	27	85	32	14	41	23	19	4	18
A.K	105	104	1	33	17	17	55	72	6	1	5	11	23	49	-	11	2	1	1	9
E.H	156	148	8	73	23	21	60	81	24	4	1	12	41	40	3	15	9	7	2	6
v.o⁹	-	-	-	-	-	12	-	12	8	2	-	2	12	-	13	15	11	11	-	4
Tot.	358	334	24	134	45	103	179	282	79	20	10	52	161	121	30	82	45	38	7	37

Treguesit për vitin 2013 kanë qënë si më poshtë;

Totali	Referime	Kryesisht	Mosfilluar	Ne verifikim	Mbartur nga viti 2012	Procedime te reja	Totali i procedime ne hetim	Pushime	Pezullime	Transferim	Gjykim	Totali perfunduar hetimet	Mbartur ne hetim per vitin 2014	Mbartur ne gjykim nga 2013	Gjithsej ne gjykim	Perfunduar gjykimi gjithsej procedime	Fajesi	Palajesie ose pushim	Mbartur ne gjykim per vitin 2014
282	271	11	83	41	93	158	250	93	21	4	42	160	103	25	72	41	33	8	30

Treguesit për vitin 2012 kanë qënë si më poshtë;

Referim	Kryesisht	Totali	Mosfillim	Pushim	Pezullim	Transferim	Gjykim	Ne hetim
271	13	284	93	72	8	6	31	74

Gjatë vitit 2015 kanë qënë në fazën e gjykimit gjithsej 105 çështje penale, me 157 të pandehur. Ka përfunduar gjykimi për 53 çështje penale, 40 prej tyre kanë përfunduar me vendim fajësie, që iu korespondojnë 51 persona të dënuar, ndërsa për 13 çështje penale është vendosur pafajësi ose pushim i çështjes.

Duke iu referuar burimit të njoftimeve të veprave penale të rregjistruara që janë në kompetencë të Njesisë së Përbashkët hetimore, vihet re se gjatë vitit 2015 numri i rasteve të referimeve penale të kryera nga shërbimet e policisë gjyqësore janë në një raport më të vogël sesa numri i kallëzimeve penale të paraqitura nga shtetasit dhe Institucionet.

Konkretisht, nga 500 materiale hetimore të trajtuara për vitin 2015, 142 janë referimet penale të dërguara nga policia e shtetit ose 28.4 %, ndërsa pjesa tjetër janë kallëzime penale nga institucionet e tjera, nga shtetasit apo të nisura kryesisht. Po

⁹ Ne kete rresht jane shenuar procedime penale qe jane hetuar nga Prokuroret e meparshem te njesise te transferuar, te cilat jane shperndare ne Prokuroret e tjere, qe nuk jane pjese e NJPH-se.
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë

kështu, nga 301 procedime penale të reja të rregjistruara në vitin 2015 vetëm 98 prej tyre janë rregjistruar mbi bazën e referimeve penale ose 32 % e tyre, ndërsa pjesa tjetër e procedimeve penale janë rregjistruar mbi bazën e kallëzimeve penale të Institucioneve apo të shtetasve të paraqitura drejtëpërsëdrejti në Prokurinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Më konkretisht, po i paraqesim të dhënat në tabelën si më poshtë vijon;

Burimi i referimit të materialeve Hetimore	Referuar	Mosfillim	Vazhdon verifikimi	Rregjistruar procedimi
Kryesisht	28			28
Pol.Shtetit	142	33	11	98
KLSH	1			1
ILDKP				
FIU	4	1	1	2
SHISH	4	1		3
D.P.T	7	1	1	5
D.P.D	23	2	1	20
A.K.K.P	35	2	1	32
Te tjera	41	14	5	22
Kallzime	216	105	21	90
TOTAL	500	159	40	301

Për vitin 2015 ka pasur rritje të kallëzimeve penale të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, krahasuar me vitin 2014, ku në periudhën e mëparshme kallëzimet kanë qënë minimale. Përvec kallëzimeve penale të dërguara drejtëpërdrejt në Prokurori, një pjesë e veprave penale në fushën e tatimeve janë referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Vlorë, si rezultat i kontrolleve të përbashkëta të realizuara me organet tatimore.

Po kështu, ka pasur rritje të kallëzimeve penale të dërguara edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ku nga dy kallëzime penale që ishin në vitin 2014, në këtë vit janë dërguar gjithsej 23 kallëzime penale.

Në vitin 2015 kemi pasur edhe raste të marrjes së informacioneve nga SHISH, ku më pas kemi mbledhur të dhënat e nevojshme në rrugë procedurale dhe kemi filluar hetime proaktive. Megjithëse numëri i rasteve të informacioneve nga SHISH kanë qënë të pakta, duhet që të përmëndim që saktësia e këtyre informacioneve ka qënë e lartë. Për vitin 2015 ka pasur raportime nga DPPP-ja më të ulëta në krahasim me vitin 2014, ndërkohë që është kërkuar nga ana jonë bashkëpunimi i këtij Insitucioni në të gjitha rastet e hetimit të veprave penale të pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale apo për procedime të tjera penale. Në të

gjitha rastet DPPP-ja ka dërguar në mënyrë korrekte informacionet e kërkuara nga ana jonë.

Për vitin 2015 një vend të vecantë në veprimtarinë hetimore kanë zënë edhe kallëzimet penale të dërguara nga A.K.K.K.P Tiranë. Në vitin 2015 janë hetuar gjithsej 36 kallëzime penale të dërguara nga A.K.K.P, nga këto 14 kallëzime penale janë dërguar në periudhën e fundit të vitit, në muajin Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2015.

Lidhur me këto kallëzim penale kanë përfunduar hetimet për 11 raste, në 2 raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal pasi kanë qënë raste të hetuara më parë, në 3 raste është vendosur dërgimi i çështjes penale në gjyq me 7 të pandehur, në 4 raste është vendosur pushimi i çështjes, si dhe në 2 raste procedimet penale janë transferuar. Për rastet e tjera hetimet ende nuk kanë përfunduar pasi vijojnë hetimet paraprake. Hetimet lidhur me këto procedime penale, për vetë natyrën dhe problematikën që ato mbartin, kanë një natyrë komplekse si dhe kërkojnë kryerjen e veprimeve të shumta hetimore.

Në tre çështjet penale të dërguara në gjyq janë marrë në përgjegjësi penale Drejtori, Përgjegjësi i Sektorit Juridik, si dhe Juristi që ka punuar praktikat, të ish Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Vlorë, ish Rregjistruesi i Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe juristi që ka punuar praktikat, ish Drejtori i Komisionit të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, si dhe personat që kanë përdorur dokumentat me të dhëna të falsifikuara.

Rastet e procedimeve penale të pushuara kanë qënë për shkakun se vepra penale e falsifikimit të dokumentave ka ndodhur por ndjekja penale është parashkruar për shkak të kalimit të afateve procedurale të parashikuara në nenin 66 të K.Penal. Megjithatë, nga ana jonë janë kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për të provuar faktin penal të falsifikimit të dokumentave dhe në përfundim të hetimeve kemi informuar edhe Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit për rikthimin e pasurive të përfituara padrejtësisht në pronësi të shtetit.

Në lidhje me hetimin e procedimeve penale të filluara mbi bazën e kallëzimeve penale të dërguara nga A.K.K.P Tiranë kanë ekzistuar disa problematika.

Megjithëse lidhur me rastet që janë kallëzuar janë kryer paraprakisht hetime administrative nga Task Forca për verifikimin e titujve të pronësisë, pranë Kryeministrit, kallëzimet penale të dërguara nuk kanë qënë të plotë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 281/4 të K.Pr.Penale, duke mos dërguar bashkëngjitur kallëzimit penal të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbi bazën e të cilit është paraqitur kallëzimi penal. Si pasojë janë krijuar vonesa gjatë hetimeve për administrimin e këtyre dokumentave dhe verifikimin më pas të elementëve të kallëzimit penal.

Për hetimin e këtyre procedimeve penale, pothuajse në të gjitha rastet, ka qënë e nevojshme kryerja e ekspertimeve dhe ekzaminimeve teknik dhe grafike të dokumentave mbi të cilat bazohen pretendimet e pronësisë, por janë krijuar vonesa në kryerjen e ekspertimeve përkatëse nga Drejtoria e Policisë Shkencore Tiranë.

Problematika tjetër lidhur me hetimin e këtyre kallëzimeve penale qëndron edhe në faktin se shpesh të drejtat e pronësisë së subjekteve të kallëzuara janë konfirmuar edhe me vendime gjyqësore, të cilat munden të gjykohen apo rishikohen vetëm nga një Gjykatë më e lartë, si dhe ekziston problematika e parashkrimit të ndjekjes penale pasi veprimet e kundraligjshme janë kryer në një kohë më të hershme se afatet e parashkrimit të ndjekjes penale.

Megjithatë, nga ana jonë në të gjitha rastet është synuar që të verifikohet fakti penal i falsifikimit të dokumentave, pavarësisht nëse ndjekja penale është parashkruar, në mënyrë që të mund të krijohet mundësia procedurale për Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, për të kërkuar në rrugë procedurale civile rikthimin e pasurisë së përfituar padrejtësisht në pronësi të shtetit. Po kështu, për të gjitha rastet janë verifikuar edhe transaksionet e mundshme të kryera lidhur me pronat e përfituara, me qëllim për të verifikuar nëse janë konsumuar elementët e veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, të parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Gjatë vitit 2015 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, në kuadër të disa procedimeve penale, është kërkuar sekuestrimi dhe konfiskimi i disa pasurive të paluajtshme dhe konkretisht;

SEKUESTRIME

1. Në kuadër të procedimit penal nr.648, viti 2013, që bën fjalë për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 287 të K.Penal, me vendim nr.206, datë 11.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*sequestro preventive*”, për pasurinë e paluajtshme nr.18/24, zona kadastrale nr.8604, vol 10, ndodhur në lagjen “1 Maji”, Vlorë, me sipërfaqe 2250 m².

Vlera e kësaj e tregut e kësaj pasurie të paluajtshme, duke marrë në konsideratë vëndndodhjen dhe prespektivën ekonomike të saj është në shumën prej rreth 200.000 euro.

2. Në kuadër të procedimit penal nr.512, viti 2014, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal, me vendimin nr.148, datë 30.03.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur masa e sigurimit “*sequestro preventive*”, për pasuritë e mëposhtme;

- Pasuria e paluajtshme e llojit ndërtesë, godinë 5-katëshe në Lagjen "Uji i Ftohtë" Vlorë, me destinacion resort turistik, me sipërfaqe totale ndërtimi 3089 m², i cili ka një vlerë tregu prej rreth 1.500.000 euro;
- Pasuria e paluajtshme e llojit truall, me sipërfaqe 2500 m², me vlerë 125.000 euro;

Vlera totale e këtyre pasurive është në shumën prej rreth 1.625.000 euro.

3. Në kuadër të procedimit penal me nr.1946, viti 2014, me vendimin me nr.261, datë 28.05.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur caktimi i masës së sigurimit "sekuestro preventive", për pasurinë e llojit kullotë, me sipërfaqe 85.000 m², ndodhur në fshatin Palasë, Vlorë.

Vlera e kësaj pasurie sipas hartës së cmimeve është në vlerën prej rreth 200.000 euro.

4. Në kuadër të procedimit penal me nr.1946 viti 2014, me vendimin me nr.418, datë 11.09.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur masa e sigurimit "sekuestro preventive", për pasurinë e paluajtshme, me sipërfaqe 128.000 m², ndodhur në fshatin Palasë, Vlorë.

- Duke marrë në konsideratë vlerat e përcaktuara në hartën e cmimeve në këtë zonë, vlera e kësaj pasurie është rreth 280.000 euro.

5. Në kuadër të procedimit penal me nr.416 viti 2015, me vendimin me nr.580, datë 06.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur caktimi i masës së sigurimit "sekuestro preventive", për pasurinë e paluajtshme me sipërfaqe 29.28 ha, e ndodhur në Himarë, e rregjistruar në rregjistrin hipotekor në emër të shtetasit Jani Qirici.

- Vlera e kësaj pasurie të paluajtshme është në total në masën 292.800 m²x31 euro= 9.076.800 euro.

6. Në kuadër të procedimit penal me nr.375 viti 2015, me vendimin me nr.551, datë 03.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur masa e sigurimit "sekuestro preventive" lidhur me pasurinë e paluajtshme të rregjistruar mbi bazën e A.M.T.P nr.20691, datë 01.09.1996, në emër të Gjon Gjonbocarit, me sipërfaqe totale prej 44.168 m².

- Vlera e tregut të kësaj pasurie të paluajtshme është në shumën prej rreth 4.400.000 euro.

Gjithsej janë sekuestruar objekti me destinacion turistik me 5 kate, sipërfaqeja prej 4750 m² tokë truall, sipërfaqeja prej 505.800 m² tokë kullotë, si dhe 44.168 m² tokë bujqësore. Sekuestrimi i këtyre pasurive të paluajtshme është kryer pasi janë pasuri që përbëjnë produkt të veprës penale, me prespektivën e konfiskimit të tyre.

Vlera totale e këtyre pasurive të sekuestruara është në shumën prej rreth 15.705.000 euro.

Përvec pasurive të paluajtshme të mësipërme, në kuadër të procedimit penal nr.1264 viti 2014, është vendosur masa e sigurimit “*sequestro preventive*” edhe për një pallat me dy seksione me 11 kate secili, të cilat nga hetimet e kryera ka rezultuar se janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme, pa u pajisur me lejën e ndërtimit përkatëse.

KONFISKIMET

1. Me vendimin e datës 30.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit të pasurive të paluajtshme si më poshtë;

- Pasuria e paluajtshme me nr.32/435, zona kadastrale nr.8604, e llojit truall, me sipërfaqe 20.039 m², ndodhur në lagjen “1 Maji”, Vlorë;
- Pasuria e paluajtshme me nr.17/1/2, zona kadastrale nr.8602, e llojit truall, me sipërfaqe 1.700 m², ndodhur në lagjen “Uji i Ftohtë”, Vlorë.
- Vlera e tregut e këtyre dy pasurive të paluajtshme, duke pasur në konsideratë vëndndodhjen e tyre si dhe prespektivën e tyre ekonomike, është në vlerën rreth 2.000.000 €.

2. Me vendimin nr.591, datë 05.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur konfiskimi dhe kalimi në favor të shtetit të pasurisë së paluajtshme nr.28/476/1, zona kadastrale nr.8603, me sipërfaqe prej 1000 m², e ndodhur në lagjen Skelë, Vlorë.

- Vlera e kësaj pasurie është në shumën prej 100.000 euro.

3. Me vendimin me nr.659, datë 03.12.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur konfiskimi dhe kalimn në favor të shtetit të pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe totale prej 128.000 m², ndodhur në fshatin Palasë, Bashkia Himarë.

- Vlera e kësaj pasurie, duke marrë në konsideratë vlerat e përcaktuara në hartën e cmimeve zyrtare në këtë zonë, vlera e kësaj pasurie është rreth 280.000 euro. Gjithsej vlera e pasurive të konfiskuara dhe të kaluara në favor të shtetit për vitin 2015 është në shumën 2.380.000 euro.

Është për tu përmëndur që të gjitha kërkesat për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të paluajtshme të dërguara nga ana jonë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, janë pranuar në të gjitha rastet nga kjo Gjykatë, duke konfirmuar kështu në të gjitha rastet bazueshmërinë në ligj dhe në prova të këtyre kërkesave.

Numrin më të madh të veprave penale të hetuara e zënë veprat penale të parashikuara nga nenet 186-191 të K.Penal. Gjatë vitit 2015 janë hetuar gjithsej 112 vepra penale të tilla, në 26 raste është vendosur pushimi i çështjes, ndërsa 17

procedime penale janë dërguar për gjykim. Gjatë kësaj periudhe janë dënuar për këto vepra penale gjithsej 16 persona.

Janë hetuar 101 procedime penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 248-258 të Kodit Penal, 33 prej tyre janë pushuar, 11 janë dërguar për gjykim, si dhe janë dënuar 10 persona për këto vepra penale.

Janë rregjistruar 16 procedime penale për veprat penale në fushën e korrupsionit, të parashikuara nga nenet 244-259 të K.Penal, 5 prej tyre janë dërguar për gjykim, ndërsa 9 procedime penale janë pushuar. Për këto vepra penale janë dënuar gjithsej 5 persona.

Është rregjistruar 1 procedim penal për nenin 319/ç të K.Penal, i cili është transferuar.

Lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 259 i K.Penal është për tu përmendur se referimet penale lidhur me këto vepra penale kanë qënë të pakta dhe me një nivel të ulët të dhënash. Nga ana jonë në të gjitha rastet këto referime penale janë rregjistruar si procedime penale, si dhe janë autorizuar përgjime në vënde publike dhe private, duke u hetuar rastet e paraqitura me hetime proaktive.

Gjatë vitit 2015 janë dërguar për gjykim persona që kanë ushtruar funksionet publike më të larta në Institucionet vendore të Qarkut Vlorë. Konkretisht, janë dërguar për gjykim 3 çështje penale më të pandehur të zgjedhur vendorë të Bashkisë Vlorë dhe Komunës Novoselë, 1 çështje penale me të pandehur ish-Rregjistruesin e Z.Rr.P.P Vlorë, 2 çështje penale me të pandehur ish Drejtorin e Z.R.K.K.P Vlorë dhe ish përgjegjës të sektorit juridik, 1 çështje penale me të pandehur ish Drejtorin e Komisionit të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, 2 çështje penale me të pandehur ish-Drejtor dhe Drejtor të Urbanistikës në Bashkinë Vlorë. Po kështu, janë dërguar për gjykim ish Kryetari i Zyrës së Përmbartimit Vlorë, si dhe punonjës të tjerë në nivelin e shefit të sektori dhe të specialistit në institucionet shtetërore vendore të Qarkut Vlorë.

Në fazën e gjykimit për vitin 2015 janë deklaruar fajtor nga Gjykata, ish Drejtori i Spitalit Rajonal Vlorë, ish Rregjistruesi i Z.V.Rr.P.P Vlorë, ish Drejtori i Arkivit Vendor Vlorë, ish Kryetari dhe Sekretari i Këshillit të Komunës Novoselë, ish Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, ish Zv/Drejtori i Portit Detar Vlorë, si dhe punonjës të tjerë në nivelin e specialistit në institucionet shtetërore vendore të Qarkut Vlorë.

Përveç sa përmendëm më sipër, lidhur me numërin më të vogël të referimeve penale në raport me kallëzimet penale të Institucioneve të tjera apo të paraqitura nga shtetasit, konstatohet që pothuajse në të gjitha rastet edhe këto referimeve penale të dërguara, janë të lidhura me kallëzime penale të shtetasve të cilët paraqesin kallëzim

penal jo drejtëpërdrejtë në Prokurori, por e paraqesin kallëzim penal pranë shërbimeve të policisë gjyqësore, të cilat përcillen më pas në formën e referimeve penale. Në raste përjashtimore janë kryer referime penale për rrethana dhe fakte për të cilat policia gjyqësore ka marrë dijeni me iniciativën e saj.

Gjithashtu, është edhe për tu përmendur fakti se gjatë vitit 2015 nuk ka pasur asnjë hetim proaktiv të filluar nga policia gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë, ndaj ndonjë funksionari publik në institucionet vendore të Qarkut Vlorë.

Është e nevojshme që shërbimet e policisë gjyqësore të kenë një rol më aktiv në drejtim të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit me iniciativën e tyre për vepra penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, si dhe në drejtim të mbledhjes së të dhënave të nevojshme me qëllim fillimin e hetimeve proaktive dhe realizimin e tyre në mënyrë sa më të suksesshme.

12. Ekzekutimet e vendimeve penale gjatë vitit 2015.

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për ekzekutimin e vendimeve penale gjatë vitit 2015 ka funksionuar seksioni përkatës ku janë ngarkuar prokurori Skënder Dautaj, dhe o.p.gj. Arjela Rexha. Për shkak të ngarkesës së punës, prokurori S.Dautaj njëkohësisht ka qenë edhe prokuror i Seksionit të të Miturve pranë kësaj prokurorie.

Gjatë vitit 2015 rezulton se janë nxjerrë në total 812 urdhëra ekzekutimi, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë. Nga këto 1 urdhër për ekzekutim të vendimit penal me burgim të përjetshëm, 168 urdhëra janë nxjerrë për ekzekutimin e vendimeve me burgim dhe 107 për ekzekutimin e dënimeve me gjobë dhe 264 për dënime alternative, 11 për bashkim dënimesh, dhe 272 urdhëra i përkasin vendimeve në lidhje me shuarje dënimi, shpenzimet gjyqësore, provave materiale etj.

Në total gjatë këtij viti janë ekzekutuar 648 urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale e konkretisht 1 urdhër për ekzekutim vendimi me burgim të përjetshëm 111 urdhëra për dënime me burgim, 264 urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale që përmbajnë dënime alternative dhe 272 urdhëra ekzekutimi të vendimeve në lidhje me shuarje dënimi, shpenzimet gjyqësore, provave materiale etj.. Po kështu, rezulton se nuk janë ekzekutuar 57 urdhëra ekzekutimi me burg dhe 107 për dënime me gjobë.

Në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale problematika kryesore është e lidhur me adresat e të dënuarve.

Vështirësi ka patur gjatë fazës së ekzekutimit ndjekja e përmbushjes së dënimit alternativ që kanë të bëjnë me shkollimin, punësimin, moslargimin nga vendi i banimit, mospërdorimin e pijes alkolike apo lëndëve narkotike, mosshoqërimi me persona të dënuar etj. Ndjekja e kësaj faze ekzekutimi kërkon një bashkëpunim dhe

bashkërendim të ngushtë të punës midis Shërbimit të Provës, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë.

13. Kompesimi për burgim të padrejtë.

Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë janë shqyrtuar përgjatë vitit 2015 4 çështje me objekt kompesim burgimi të padrejtë, në një shumë totale prej 44.388.570 lekësh, që i përket 4 vendimeve penale. Bëhet fjalë për çështje penale të viteve të mëparshme që kanë kaluar shkallët e gjyqësorit, por çmohet se nga jonë duhet treguar kujdes i posaçëm në vlerësimin e rrethanave dhe kriterëve në caktimin e masës të sigurimit “arrest në burg”, por dhe në vlerësimin e drejtë të provave në fazën e hetimit dhe të gjyqimit të çështjes.

14. Aktiviteti i zyrës së financës për vitin 2015

Aktiviteti i zyrës së financës është i lidhur drejtpërdrejt me mbarëvajtjen e punës së prokurorisë dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore gjatë një procedimi të rregullt penal.

Zyra e financës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë trashëgon prej vitesh një borxh financiar në lidhje me pagesat e ekspertëve, avokatëve dhe përkthyesve. Gjatë vitit 2015 ky borxh ka qënë në shumën 5.502.755 lekë, është arritur të shlyhet një shumë lekësh prej 2.603.830 dhe është trashëguar për vitin 2016 një borxh prej 2 898 925 lekë. Këtu pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për ekspertë të ndyshëm ekspertime mjeko-ligjore, shpenzimet për avokatë, përkthyesë etj.

15. Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë gjatë vitit 2015.

Gjatë vitit 2015, rezulton se ka patur një ngarkesë të konsiderueshme pune edhe në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja dhe konkretisht gjatë këtij viti i janë dërguar autoriteteve gjyqësore kompetente 35 kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale, ndërkohë që janë dërguar prej autoritetet gjyqësore të huaja në drejtim të Prokurorisë Vlorë 28 kërkesa për ndihmë juridike në fushën penale. Po kështu, rezulton se është bërë 5 njohje vendimi penal të huaj dhe 4 procedura për arrestime të përkohshme me qëllim ekstradimi, për të cilat në të gjitha rastet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka miratuar ekstradimin.

Konstatohet një korrektësi maksimale në raport me autoritetet gjyqësore të huaja në përmbushjen e detyrimeve ligjore, në një kohë kur pritet që edhe autoritet e huaja gjyqësore të na përgjigjen me të njëjtën shkallë korrektësie.

16. Marrëdhëniet me institucionet e tjera.

Gjatë vitit 2015 është synuar rritja e bashkëpunimit sidomos me strukturat e policisë së shtetit, që përbën një element shumë të rëndësishëm të suksesit në punën e prokurorisë. Bashkëpunimi i mirë ka funksionuar si në nivel titullarësh por edhe në nivelin bazë dhe ka dhënë rezultatet e veta. Theksi është vënë në përmbushjen e detyrimeve të policisë gjyqësore, rritjen e nivelit profesional të tyre, eliminimin e zvaritjeve të pa justifikuara dhe ritjen e cilësisë së hetimit me qëllim për të qënë më të suksesshëm në parandalimin dhe goditjen, sidomos të veprave penale më të përhapura në këtë rreth.

Ka një përmirësim të bashkëpunimit me pushtetet vendore dhe institucionet e tjera lokale me synimin për të marrë prej tyre në kohë informacionin e nevojshëm në interes të hetimit. Edhe përsa i përket ekzekutimit të vendimeve penale, bashkëpunimi me IEVP Vlorë dhe Shërbimin e Provës ka qënë mjaft i mirë.

Përsa i përket marrëdhënieve të punës me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ato kanë qënë korrekte dhe të bazuara në ligj. Ka patur një përmirësim të ndjeshëm të raporteve me këtë gjykatë sidomos për zgjidhjen e problemeve të natyrës administrative.

Me Prokurorinë e Apelit Vlorë vazhdojnë të ruhen marrëdhënie të mira shoqërore dhe institucionale. Kjo prokurori na ka mbështetur në të gjitha kërkesat tona të ligjshme dhe ka orientuar qëndrimin tonë për çështje konkrete.

19. Problemet e konstatuara dhe prioritetet.

Me synimin për të arritur rezultate më të mira për këtë vit kalendarik është e nevojshme të bëjmë prezent disa problematika të konstatuara gjatë vitit 2015.

- ✓ Nga prokurorët dhe of.pol.gjyqësore kërkohet më shumë përkushtim në përmbushjen e funksionit që kryejnë.
- ✓ Prania e vetëm një eksperti mjeko-ligjor për rrethin e Vlorës krijon probleme të ndryshme gjatë fazës së hetimeve paraprake që lidhen me qëndrimet si për cilësimin e veprës, masën e sigurimit dhe afatet e hetimit.
- ✓ Mungesa e ekspertëve autoteknik në strukturat e policisë së shtetit krijon të njëjtat probleme si dhe i hap rrugë konkluzioneve jo të sakta nga ekspertë të jashtëm të cilët nuk kanë marrë pjesë në kqyrjen e vendit të ngjarjes.
- ✓ Shtimi i numrit të popullsisë gjatë periudhës së verës, shton dukshëm dhe numrin e veprave penale të rregjistruara.

Prioritetet e punës së kësaj prokurorie gjatë vitit 2016 do të jenë:

- ✓ Më shumë angazhim e profesionalizëm për fazën e hetimit paraprak. Nga rezultatet e kësaj faze varen të gjithë treguesit e tjerë cilësorë të punës.
- ✓ Më shumë kontroll për veprimtarinë e policisë gjyqësore përmes monitorimit të sasisë, cilësisë dhe kohëzgjatjes së veprimeve të kryera.
- ✓ Rritje e efikasitetit të hetimit për veprat penale të rënda dhe ato që lidhen me mospërmbushjen e rregullt të detyrës nga nënpunës të institucioneve të ndryshme, korrupsionin si dhe veprat penale të cilat janë shqetësuese në këtë rreth.

Duke ju falënderuar për vëmëndjen.

DREJTUESI PROKURORISË

RAMADAN TROCI